



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 11/2 Prot.

Tiranë, më 13.2.2018

VENDIM

Nr. 07, datë 13.2.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr. 1600 Prot., datë 18.12.2017, kundër Autoritetit Publik "Avokatura e Shtetit" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik"), me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

Me kërkesën e datës 23.11.2017, ankuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

- 1. Cilat kompani private janë në arbitrazh ndërkombëtar për shkak të zgjidhjes së kontratave me shtetin shqiptar dhe a i referohet këtyre çështjeve shuma 2 miliardë euro deklaruar nga ish-Ministri i Drejtësisë?*
- 2. Cilat kompani private kanë fituar gjyqin ndaj shtetit shqiptar dhe sa është dëmi i shkaktuar ndaj buxhetit shtetëror?*
- 3. Akses në dokumentacionin që iu mundësoi zbulimin e këtyre fakteve lidhur me gjyqet dhe arbitrazhet?*

Avokatura e Shtetit, i është përgjigjur ankuesit nëpërmjet postës elektronike duke refuzuar dhënien e informacionit me argumentin se vënia në dispozicionin e tij kufizohet

nga e drejta për informim, konkretisht gërma dh) e pikës 2 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “Ligji për të Drejtën e Informimit”).

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv si dhe në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit për të Drejtën e Informimit” në të cilin shprehimisht thuhet se “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore me datë 15.01.2018.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik argumentuan në tërësi refuzimin duke dhënë për të tre pikat e kërkesës sqarimet si më poshtë:

1- *Informacioni i kërkuar, kufizohet për shkak të konfidencialitetit, i cili ka qenë i parashikuar në kontratë, në dokumentet procedurale të prodhuara nga trupa e gjyqimit (urdhra procedural të cilët duke qenë prodhuar në një proces konfidencial, konsiderohen të tillë dhe nuk mund t'i sigurohen publikut), rregullat e Dhomës së Arbitrazhit të ICC ku parashikohet se: “Puna e Gjykatës është e një natyre konfidenciale dhe duhet të respektohet nga të gjithë ata që marrin pjesë në atë punë në çfarëdo kapaciteti”; Në të kundërt shteti Shqiptar do të ekspozohet para një serie rreziqesh të konsiderueshme, të tilla si kosto financiare shumë të larta dhe kompromentim të rëndë të imazhit të shtetit, përfshirë edhe një paragjykim të pozitës së tij në rastet të supozuara konfliktesh me investitorë të mundshëm, në sytë e trupave të gjyqimit në proceset e arbitrazhit, palëve ndërgjyqëse në gjykim, dhe aktorëve të tjerë në të drejtën ndërkombëtare private.*

Marrëdhënia e Avokaturës së Shtetit me institucionin/entin publik të paditur në arbitrazh karakterizohet nga parimi i privilegjit që rregullon marrëdhënien avokat-klient, rrjedhimisht, institucioni i Avokaturës së Shtetit, si përfaqësuese e shtetit Shqiptar apo institucioneve të posaçme të tij/enteve publike, e ka të pamundur të bëjë publike të dhëna të cilat i janë komunikuar nga pala të cilën mbron apo pala tjetër në proces. Kjo është deontologjia e profesionit të avokatit pavarësisht pozicionit të tij, si mbrojtës i shtetit apo mbrojtës i një subjekti privat, sipas parimit Klient – Avokat, (në bazë të të cilit operon Avokatura e Shtetit në raport me shtetin apo institucionet e tij kur janë të paditura në arbitrazhin ndërkombëtar) – më konkretisht sipas ligjit të posaçëm Nr. 9109/2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në nenin 9/3 parashikohet se: “Avokatit i ndalohe të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim”.

2- *Baza ligjore vendase për mospajtim të informacionit, konkretisht ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 17, njeh të drejtën e kufizimit të informacionit që mund të jepet nga organi shtetëror, mbajtës i tij, i cili, në lidhje me parashikime të tjera ligjore, ngarkohet me përgjegjësi penale për përhapjen e këtij informacioni. Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ndër kufizimet e tij, në nenin 17, parashikon, se: “{...}1.*

E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor; {...}”

Ankuesi Z. , gjatë seancës dëgjimore u shpreh se i qëndron të njëjtave pretendime të shprehura në ankesë.

Komisioneri vlerëson se në shqyrtimin e çështjes, gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “Kodi i Procedurës Civile”), Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, e nënshkruar në Gjenevë me datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin nr. 8687, datë 09.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit”, Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit e nënshkruar në New York me datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me Ligjin nr.8688, datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, si dhe Ligji nr.10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”.

Komisioneri vlerëson se argumentet e dhëna nga autoriteti publik mbi refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar, nuk qëndrojnë për arsyt e renditura në vijim.

Sa i përket pikës së parë të kërkesës për informacion, vlen të theksohet se ajo konsiston në listën emërore të shoqërive tregtare të cilat janë në procedurë arbitrazhi ndërkombëtar me shtetin shqiptar. Pra, informacioni i kërkuar përbën një të dhënë faktike dhe duke iu referuar dispozitës së cituar dhe nga Autoriteti Publik në refuzimin e tij (dhe më konkretisht nenit 17, pika 2, gërma dh) e Ligjit për të Drejtën e Informimit), paragrafi i dytë i kësaj pike parashikon se: *“Kufizimi mbi të drejtën e informimit për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, gërma dh) nuk zbatohet kur të dhënat e kërkuara janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose statistikore”*.

Rrjedhimisht, dhënia e këtij informacioni nuk do të cënonte as barazinë e palëve dhe as mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

Sa i përket pikës së dytë të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik shprehet mbi konfidencialitetin duke mos cituar referencën ligjore për klasifikimin e informacionit si të tillë. Gjithashtu, në përgjigjen e kthyer nuk rezulton bashkëlidhur asnjë dokument/marrëveshje ku të përcaktohet konkretisht cili informacion konsiderohet konfidencial. Gjithashtu, Autoriteti ka referuar rregullat e Dhomës së Arbitrazhit ku parashikohet konfidencialiteti, por ky argument vlen vetëm për procedurën e shqyrtimit nga gjykata dhe vetëm për çështjet që mund të jenë në proces dhe jo për informacionin e kërkuar nga kërkuesi.

Komisioneri vlerëson se pavarësisht pretendimit të Autoritetit Publik lidhur me natyrën konfidenciale të punës së gjykatës së arbitrazhit, (pretendim i cili nuk gjen mbështetje as në Konventën Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar dhe as në Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit), sa i përket marrëveshjes së arbitrazhit apo dokumenteve të tjera proceduriale, duke qenë se palë në marrëveshje

është shteti shqiptar dhe rrjedhimisht çështja prek fondet publike, këto dokumente përmbushin kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Për më tepër kur procedura e arbitrazhit vjen si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve që lindin nga zbatimi i kontratave të konçensionit apo partneriteteve publiko private, edhe vetë shoqëria private klasifikohet si Autoritet Publik në kuptim të pikës 1, gërma b (ii) dhe c e nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Ky argument gjën mbështetje dhe në faktin se referuar nenit 399 të Kodit të Procedurës Civile, vendimet e një gjykate arbitrazhi të huaj njihen dhe zbatohen në Shqipëri nëpërmjet procedurës së përshkruar në Kreun IX të këtij Kodi. Ky kre parashikon që vendimet e gjykatave të arbitrazhit të huaj njihen dhe zbatohen në Shqipëri me vendim të Gjykatës së Apelit. Bazuar në nenin 396 të Kodit të Procedurës Civile bashkëlidhur kërkesës për njohje paraqitet dhe një kopje e vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj.

Nisur nga sa më sipër dhe bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 146 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 2 të të cilit thuhet se: *“Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”*, rrjedh se parimi i konfidencialitetit i pretenduar nga Autoriteti Publik nuk mund të gjejë zbatim.

Lidhur me argumentin e dhënë nga Autoriteti Publik se dhënia e informacionit ndalohej sipas nenit 9, pika 3 e Ligjit nr.9109 datë 17.07.2003 *“Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, Komisioneri konstaton se ligji i sipërcituar rregullon profesionin e avokatisë si profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar, ndërsa avokati i shtetit është nëpunës i administratës publike dhe parimet e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit janë të cituara në nenin 3 të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 *“Për Avokaturën e Shtetit”*.

Për më tepër asnjë nga elementët që karakterizojnë profesionin e avokatisë si profesion i lirë nuk mund t'i vishet rolit të Avokaturës së Shtetit e cila, bazuar në pikën 1 të nenit 2 të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 *“Për Avokaturën e Shtetit”* është institucioni qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Bazuar në këtë përcaktim, Avokatura e Shtetit klasifikohet si Autoritet Publik në kuptim të nenit 2, pika 1 e Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe rrjedhimisht nuk mund të refuzojë vënien në dispozicion të dokumenteve dhe informacioneve që ajo administron apo prodhon në kuadër të përmbushjes së detyrave të saj publike.

Gjithashtu, Komisioneri konstaton se bazuar në nenin 6, pika f dhe g e Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 *“Për avokaturën e shtetit”*, kjo e fundit ka për detyrë të paraqesë raporte vjetore ose të raportojë rast pas rasti tek Ministri i Drejtësisë mbi çështje që në thelb kanë të bëjnë me informacionin e kërkuar nga ankuesi. Këto raporte janë publike në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Sa i përket pjesës së dytë të pikës së parë të kërkesës për informacion (*dhe a i referohet këtyre çështjeve shuma 2 miliardë euro deklaruar nga ish-Ministri i Drejtësisë?*), Komisioneri vlerëson se ajo nuk përbën informacion publik në kuptim të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe për pasojë nuk mund të urdhërojë Autoritetin Publik që të shprehet lidhur me pyetjen që i drejtohet.

Pika e tretë e kërkesës për informacion, është e paqartë në formulim. Për këtë arsye, Komisioneri nuk mund të shprehet.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. ndaj Autoritetit Publik, Avokatura e Shtetit, Komisioneri vlerëson se ankesa është pjesërisht e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të Ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

V E N D O S A:

- 1- Pranimin pjesërisht të ankesës së Z. me nr. 1600 Prot., datë 18.12.2017, ndaj Autoritetit Publik Avokaturës së Shtetit me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
- 2- Urdhërimin e Autoritetit Publik, Avokatura e Shtetit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar dhe më konkretisht:
 - *Cilat kompani private janë në arbitrazh ndërkombëtar për shkak të zgjidhjes së kontratave me shtetin shqiptar?*
 - *Cilat kompani private kanë fituar gjyqin ndaj shtetit shqiptar dhe sa është dëmi i shkaktuar ndaj buxhetit shtetëror, brenda datës 20. 2 .2018;*
- 3- Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 2 .2018.

